



Tribuna Channel
Besiana Hoti
Drejtoreshë
Prishtinë

Rasti Nr. 2018/203
Ref:1902/129/KPM/mf

VENDIM

Lidhur me Rastin Nr. 2018/203 – Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) për Tribuna Channel (Palë Përgjegjëse)

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) me datën 28 maj 2013 ka miratuar Rregulloren KPM 2013/02 për të Drejtën e Autorit në Shërbimet Mediale Audiovizuale. Me këtë rregullore janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e shërbimeve mediale audiovizuale lidhur me respektimin e të drejtës së transmetimit dhe ritransmetimit
2. KPM në datat 17, 19 dhe 21 nëntor 2018 ka bërë monitorimin e programeve të Palës Përgjegjëse për të vlerësuar pajtueshmërinë me Rregulloren KPM 2013/02.
3. KPM me datën 5 dhjetor 2018 me anë të një shkrese i ka kërkuar Palës Përgjegjëse që brenda afatit prej pesë (5) ditësh të sjellë kontratat valide për transmetimin e filmave të animuar “*Mensuno*” dhe “*Puppy in my pocket*”, për serialin vendor “*Stinë Dashurie*”, serialet e huaja “*Aurora*” dhe “*Mos u brengos për mua*”, si dhe filmat artistikë “*Shattered-Buterfly in on a Wheel*”, “*Elegy*” dhe “*Big Stan*”.
4. KPM brenda afatit të paraparë nuk ka pranuar asnjë përgjigje nga Pala Përgjegjëse.
5. KPM në bazë të Raportin e monitorimit të datës 20 dhjetor 2018 ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka transmetuar përmbajtje programore pa të drejtë autoriale, duke vepruar në kundërshtim me Rregulloren KPM-2013/02.
6. KPM pas të gjeturave nga Raporti i monitorimit, me datën 11 janar 2019 i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për shkelje me të cilin e ka njoftuar për shkeljet e bëra dhe i ka kërkuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2013/02. Po ashtu, i ka ofruar mundësinë që brenda afatit prej tre (3) ditësh, pas pranimit të shkresës, të përgjigjet dhe të ofrojë sqarimet e tyre në raport me shkeljet e gjetura.

Analiza Ligjore

7. Komisioni bazuar në të gjitha faktet dhe analizat e lartpërmendura konstaton se Pala Përgjegjëse është gjetur në shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/02

Neni 4, paragrafi 1, i Rregullores KPM-2013/02, përcakton se:

"Të Licencuarit i kërkohet të veprojë në përputhje me Ligjin për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta 04/L-065 si dhe ligjet tjera në zbatim në Republikën e Kosovës për pronësinë intelektuale, dhe në veçanti të sigurojë marrëveshje të vlefshme për të drejtën e autorit dhe leje për përdorimin veç e veç dhe në tërësi të të gjithë programeve komerciale. Këtu përfshihet riprodhimi, ritransmetimi dhe ritransmetimi i njëkohshëm i sinjaleve të huaja dhe të importuara, qoftë nga emetues tokësorë të largët ashtu edhe nga sinjale dhe programe që rrjedhin nga sateliti. Në rastin kur programi konsiderohet i zotërimit publik, prodhimi i të cilit është më i vjetër se 70 vjet, nuk kërkohet një leje e tillë."

Komisioni në bazë të Raportit të monitorimit ka gjetur se Tribuna Channel për transmetimin e filmave të animuar "Mensuno" dhe "Puppy in my pocket", për serialin vendor "Stinë Dashurie", serialet e huaja "Aurora" dhe "Mos u brengos për mua", si dhe filmat artistikë "Shattered-Butterfly in on a Wheel", "Elegy" dhe "Big Stan", nuk ka siguruar marrëveshje për të drejtën e autorit.

8. Komisioni ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe pas Njoftimit për shkelje të dërguar nga KPM, ka dështuar t'i sjellë marrëveshjet për të drejtën e autorit, me çka ka dështuar të veprojë në pajtim me Rregulloren KPM-2013/02.
9. Komisioni duke u bazuar në faktet e lartpërmendura ka gjetur se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/02.

Vendim

1. Obligohet Pala Përgjegjëse që ta ndërpresë menjëherë transmetimin e përmbajtjeve për të cilat nuk posedon marrëveshje valide të të drejtave të autorit dhe të sigurohet se një gjë e tillë nuk do të përsëritet, siç e përcakton neni 5, paragrafi 2, i Rregullores KPM-2013/02;
2. Pala Përgjegjëse sanksionohet me gjobë në vlerën prej 1,000 (njëmijë) euro në pajtim me nenin 30, paragrafi 1.3 të Ligjit të KPM-së, për shkelje të nenit 4, paragrafi 1, të Rregullores KPM-2013/02 për të Drejtën e Autorit në Shërbimet Mediale Audiovizuale.

E drejta për Ankesë

10. Ankesat i parashtrohen Bordit për Ankesa brenda tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i Vendimit të KPM-së në pajtim me nenin 29, paragrafi 5, të Ligjit të KPM-së. Ankesa bëhet me shkrim dhe duhet të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave në pajtim me nenin 42, paragrafi 2, të Ligjit të KPM-së.
11. Bordi për Ankesa do t'i merr parasysh vetëm ankesat e bazuara në informacione ligjërish të relevante të cilat nuk ishin të disponueshme në kohën e marrjes së vendimit të KPM-së, apo të bazuara në mundësi se ekzistonte gabim procedural dhe material i bërë nga ana e KPM-së gjatë marrjes së vendimit.



Muja FERATI
Kryetar



05.02.2019
Datë